



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:110350
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05641485

C.A.P. nr. 1256/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin individual Besnik Bislimaj, në çështjen juridike-përmbare të kreditorit KUR Mitrovica Sh.A., me adresë rruga “Bislim Bajgora”, Komuna e Mitrovicës, kundër debitorit S. M. C. me adresë rruga “T..”, Komuna e Mitrovicës, për realizimin e borxhit për furnizim me ujësjellës dhe shërbimet e kanalizimit, në lartësi të borxhit prej 2,498.48 euro, duke vendosur sipas ankesës së kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PPP.nr. 143/2023 datë 01.08.2023, me datë 30.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit KUR Mitrovica Sh.A., me adresë rruga “Bislim Bajgora”, Komuna e Mitrovicës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PPP.nr. 143/2023 datë 01.08.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar PPP.nr. 143/2023 datë 01.08.2023, ka vendosur: KONSIDEROHET se është tërhequr propozimi për përmbare të kreditorit KUR Mitrovica Sh.A., ndaj debitorit të përmbaremit S. M. C. nga Komuna e Mitrovicës, meqenëse kreditori nuk ka vepruar konform udhëzimeve të dhëna me konkluzionin PPP.nr.143/2023 të datës 10.07.2023.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori: për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e kreditorit dhe ta prishë aktvendimin e atakuar dhe lëndën ta kthejë në Gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se kreditori KUR Mitrovica Sh.A., me adresë rruga “B. B.”, Komuna e Mitrovicës, pranë përmbaruesit privat I. M., me seli në Mitrovicë, me datë 19.04.2023, ka parashtruar propozim për përmbarim, kundër debitorit S. Ç. na Mitrovica, për shkak të borxhit.

Përmbaruesi privat I. M., me seli në Mitrovicë, me urdhër P.nr. 52/2023 të datës 20.04.2023, ka lejuar propozimin për përmbarim, kundër të cilit urdhër përmbarimorë debitori ka ushtruar prapësim, ndërsa kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata e shkallës së parë, pas analizimit të propozimit për përmbarim si dhe dokumentin e besueshëm ka mare konkluzion PPP.nr. 143/2023 datë 10.07.2023, përmes së cilit obligohet kreditori që në afat prej tre (3) ditësh ta bëjë plotësimin e propozimit për përmbarim, përmes së cilës ka kërkuar që të specifikoj saktë lartësinë e kërkesës duke u bazuar në dokumentin e besueshëm për periudhën kohore prej 30.01.2022 e deri më 31.10.2022, përkatësisht si në dispozitiv të këtij konkluzioni, vendim të cilin kreditori i përmbarimit e kishte pranuar me datë 19.07.2023

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr. 143/2023, të datës 01.08.2023, ka konsideruar të tërhequr propozimin për përmbarim të kreditorit për shkak të mos veprimit sipas konkluzionit të cekur më lartë, duke vendosur më saktësisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e shkallës së parë, në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar ka arsyetuar se: Gjykata pas shqyrtimit paraprak të çështjes përmbarimorë, e duke u bazuar në shkresat të cilat janë në lëndë, Gjykata ka hasur në një mospërputhje të borxhit të kërkuar më propozim për përmbarim, e që është borxhi 2,498.48 euro, përderisa në bazë të dokumentit të besueshëm-Kartelën Financiare të Konsumatorit (CODE: 001191) për ofrimin e shërbimeve komunale-furnizim me ujësjellës dhe shërbimet e kanalizimit për periudhën 01.02.2022 deri më 31.03.2023, në shumën 684.46 euro.

Më tej ka arsyetuar se: Lidhur më këtë situatë të krijuar, kjo Gjykatë më Konkluzionin PPP.nr.143/2023 të datës 10.07.2023 e ka urdhëruar kreditorin që në afat prej 3 ditësh, nga marrja e këtij konkluzioni ta plotësoi propozimin për përmbarim, ashtu që të konstatoi sakët sa është borxhi për periudhën 01.10.2020 deri më datën 31.10.2022, më vërejtjen se nëse nuk veprohet sipas udhëzimeve në konkluzion, gjykata propozimin për përmbarim do ta konsideroj se është tërhequr, po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e ne qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtresa do të hidhët poshtë. Kreditorit më datë 19.07.2023, e ka pranuar konkluzionin në fjalë, mirëpo në afatin e paraparë prej 3 dite, nga shkresat e lëndës rezulton se i njëjti nuk ka vepruar sipas asaj që i është kërkuar me konkluzion.

Lidhur me mënyrën e vendosjes është bazuar në nenin 17 të LPP e në lidhje me nenin 102 paragrafi 3 të LPK.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, si dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkelje gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson vendimin e marrë si të drejtë dhe të ligjshëm nga Gjykata e shkallës së parë, pasi që siç shihet nga shkresat e lëndës gjykata e shkallë së parë, me konkluzion PPP.nr.143/2023 të datës 10.07.2023, kreditorit i kthen në plotësim propozimi për përmbarrim, duke kërkuar nga kreditori që ta plotësoj propozimin për përmbarrim në lidhje me lartësinë e borxhit për periudhën 01.10.2020 deri më datën 31.10.2022, pasi që borxhi i kërkuar me propozim ishte i pa kjar dhe nuk kishte mbështetje në dokumentin e besueshëm – Ekstrakt nga Librat e Kontabilitetit, duke i tërhequr vërejtjen se propozimi për përmbarrim do të konsiderohet e tërhequr nëse nuk i kthehet gjykatës brenda afatit ligjor dhe nëse kthehet e pa korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, do të hedhet poshtë. gjë që paditësit nuk kanë vepruar konform aktvendimit dhe gjykata duke u bazuar në nenin 102.3 të LPK-së, ka marrë vendimin e ankimuar.

Gjykata e Apelit vlerëson si të drejtë aktvendimin e ankimuar të gjykatës së shkallë së parë, pasi që duke u bazuar në nenin 102.3 të LPK-së, i cili parasheh që *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë”*. Andaj, në rastin konkret, kreditori kishte për obligim ligjor që të veproj konform konkluzionit me të cilin është obliguar që plotësoj propozimin për përmbarrim në lidhje me konstatimin e lartësisë borxhit për periudhën e cekur si më lartë, pasi që është obligim ligjor i kreditorit që në propozim për përmbarrim të përcaktoj saktë periudhën kohore si dhe lartësinë e borxhit duke u mbështetur në dokumentin e besueshëm, sipas nenit 38 par. 1 të LPP-së, i cili parasheh që *“1. Propozimi për përmbarrim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarrimi, kërkuesi i përmbarrimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarrimi, objekti i përmbarrimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit”*, ndërsa sipas par 2 të po të njëjtit nen është paraparë që *“2. Në rast se propozimi për përmbarrim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarrues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*. Në rastin konkret mungesa e elementit të përcaktimit të vlerës së borxhit, e bënë propozimin për përmbarrim si jo të rregullt ashtu që gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vepruar si në konkluzionin e cekur si më lartë, pasi që ka qenë e pa mundur që të veprohet më tutje në këtë çështje përmbarrimore.

Gjykata e Apelit i analizoj pretendimet tjera të kreditorit, por gjeti se të njëjtat janë pa ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 209 pika b), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
C.A.P. nr. 1256/2023 datë 30.04.2024

Gjyqtari,
Besnik Bislimaj, d.v